



Crna Gora - Mali i Zi  
Opština Ulcinj - Komuna e Ulqinit

|                   |            |
|-------------------|------------|
| Primitje - Pritje | 22.12.2020 |
| Qitje - Kështj    |            |
| Broj - Numër      | 02-21/20-3 |
| Prilog - Bashkë   |            |
| Vrijed - Vlerë    |            |

Crna Gora – Mali i Zi  
Opština Ulcinj - Komuna e Ulqinit  
KOMUNALNA POLICIJA – POLICIA KOMUNALE  
Broj/Numër 02-21/20-3  
Ulcinj - Ulqin, 21.12.2020

### KUVENDIT TË KOMUNËS

Përgjigje në pyetjen e z.Marko Shkrela

Në lidhje me pyetjen e z. Marko Shkrela – lidhur me bagëtiet e trasha të cilat qarkullojnë në qendër të Shtojit dhe përgjatë rrugës magjistrale nga Port Milena deri te lumi Buna ju njoftojmë si më poshtë.

Policia komunale gjatë aktivitetit të vetë të përditshëm në mes tjerash bënë edhe mbikqyrjen e terrenit mbi lëvizjen e bagëtive në këtë pjesë të qytetit.

Në këtë aspekt, ne, gjatë vitit 2020 kemi bërë disa aksione për kapjen e tyre dhe atë:

- Me datë 13.02.2020; më 21.02.2020; më 06.03.2020; më 10.07.2020; më 18.07.2020; më 07.08.2020; më 14.12.2020; më 15.12.2020; më 16.12.2020; më 17.12.2020 dhe më 18.12.2020.
- Më 17.12.2020 policia komunale ka dënuar një qytetar të Shtojit, ku në bazë të numrit që ka pasur në vath bagëtia është bërë identifikimi i pronarit.

Ju njoftoj që Policia Komunale do të jetë në shërbim të qytetarëve të kësaj zone, por ne nuk jemi kompetent të bëjmë kapjen e bagëtive, por i asistojmë dhe ndihmojmë Ndërmarrjen për Veprimtari Komunale pasi ajo ka kontratë me Komunën e Ulqinit për kapjen e bagëtive në fjalë.

Si zgjidhje të këtij problemi unë e shoh që Ndërmarrja për Veprimtari Komunale duhet të paiset me mjetet adekuate në mënyrë që të bëhet e mundur kapja e tyre.

Me respekt

UD Kryeshefi,  
Milazim Mustafa